

FJALA E DEPUTETIT XHELAL MZIU

E HËNË 31 TETOR 2022

Të nderuar qytetarë,

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Është kënaqësi, por edhe përgjegjësi e jashtëzakonshme për mua si ish-kryetar bashkie dhe si anëtar i qarkut të Tiranës, por edhe si komisioner i reformës territoriale dhe sot e shikoj me dhimbje, në fakt, reformën e implementuar në vitin 2014. Pushteti vendor sot në Shqipëri është shumë herë më keq sesa 8 vjet më parë dhe kjo vjen për shkak të reformës së njëanshme të zhvilluar në vitin 2014, kur pushteti vendor bëri hapa mbrapa, ose më saktë, pati shumë pak risi pozitive, por në themel tregon edhe njëherë që pushteti vendor ka njohur një regres të jashtëzakonshëm, krahasuar me 8 vjet më parë.

Si një ish-kryebashkiak, por edhe si një qytetar i thjeshtë, e vlerësoj pushtetin vendor si një nga instrumentet më të rëndësishme që ka të bëjë me qytetarët, por reforma e njëanshme e vitit 2014 e ka delegjitimuar pushtetin vendor. Në fakt, në këtë drejtim edhe Partia Demokratike ka jo pak faj. Largimi nga reforma, mosparaqitja e një drafti në vitin 2014 apo braktisja e zgjedhjeve të vitit 2019 i dha mundësi kësaj maxhorance për ta delegjitimuar pushtetin vendor. Sot pushteti vendor është kthyer në një shtojcë, madje është kthyer në një patericë të qeverisë. Kjo ka bërë që të mos kemi pushtetin vendor që ne kërkojmë, por të kemi një pushtet vendor, i cili e ka rrënuar ndjeshëm rolin e qytetarëve.

Reforma territoriale, e zhvilluar 8 vjet më parë, u shit si një histori suksesi, në fakt, jo vetëm që nuk është një histori suksesi, por është një histori që as në rajon, as në Europë dhe në asnjë vend të botës nuk mund ta gjesh. Si mundet një maxhorancë, që bën një reformë territoriale, me një të rënë të lapsit, nga 373 njësi i ul në 61 njësi?! Cili është, në fakt, etaloni që ka përdorur? Në fakt, reforma territoriale nuk ka ndjekur një praktikë ndërkombëtare. Në çdo vend të botës është referendumi dhe për t'u bashkuar duhet pëlqimi i zonave. Sot edhe diku në një bashki, kur bëhet një rrugë e vogël, duhet të pyesësh grupet e interesit. Në fakt, reforma territoriale u bë në mënyrë të njëanshme. Me një të rënë të lapsit, nga 373 njësi janë vetëm 61 njësi, sepse kështu i interesonte qeverisë së "Rilindjes". Reforma territoriale jo vetëm që nuk njohu konsultime, por u bë pa një paketë ligjesh.

Edhe sot që ne flasim, pas 8 vjetësh, kemi vakuume ligjore; nuk ka kompetencë pushteti vendor në shumë drejtime, madje i janë zvogëluar edhe kompetencat e para viteve 2015. Konfigurimi i hartës elektorale nuk ndoqi një standard; u tha që do të kishte 10 mijë banorë, por kemi më shumë sesa çerekun e bashkive që kanë më pak sesa ky interval. Në fakt, reforma territoriale pati edhe një disproporcion krahinor. Nëse në zonën e Jugut patëm një fragmentarizëm të krijimit të njësive vendore; në zonën e Veriut ndodh ndryshe; patëm një amalgim të disa njësive vendore. Shembulli më i qartë i kësaj është qarku i Gjirokastrës, që është tri herë më pak sesa qarku i Lezhës; në Gjirokastrë 7 njësi vendore, në Lezhë vetëm 3 njësi vendore.

Nëse shohim vetëm një bashki, Dibra nga 17 njësi vendore, u konvertua në një njësi vendore. Nëse shohim Memaliajin, nëse shohim Këlcyrën, vazhdojnë të jenë një. Pra, ky është një disproporcion i qartë që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe te shpopullimi, edhe te bujqësia, edhe në shumë standarde të tjera që kanë ndikuar ndjeshëm negativisht te qytetarët. Pra, kufijtë nuk kanë dalë nga vullneti i qytetarëve, por kufijtë janë bërë nga harta apo oreksi i Kryeministrit për të implementuar një pushtet vendor që t'i shërbejë në qeverisjen e tij, pa pasur po themi, të tjerë që e shqetësojnë.

U trumbetua një kauzë: taksa e pasurisë nga 0,3% ,që ishte, do të shkonte në 0,8%. Edhe sot, pas 8 vjetësh, është vetëm 0,3%, kur presupozohej se ajo do të shkonte 0,3% vetëm 4 vjetët e parë. Madje, është më pak sesa atëherë, por nuk është vetëm aq. Nëse do të shohim grantin e fillimvitit, vazhdon të jetë 1% siç ishte edhe më përpara. Në fakt, vendet e rajonit, që janë edhe më pranë nesh, e kanë 4% të GDP-së dhe, nëse shikojmë vendet e Bashkimit Europian, ajo shkon në 10% apo 15 %. Ky është standardi që kemi krijuar. Në fakt, nuk është se i dhamë autonomi financiare. Të ardhurat e pushtetit vendor në këta 8 vjet kanë pasur një rritje, por të ardhurat e pushtetit vendor, në raport me të ardhurat e buxhetit të shtetit, kanë pasur një rënie.

Pra, buxheti i shtetit është rritur në progres, në fakt, rritja e pushtetit vendor ka qenë minimale; abuzohet me të ardhurat e pushtetit vendor. Po t'i shohësh të ardhurat e pushtetit vendor, 55% e të ardhurave i merr Bashkia e Tiranës, vetëm 45% e të ardhurave në rang vendi i marrin 60 bashki. Në fakt, Bashkia e Tiranës edhe ato 55% i merr për shkak të kullave që janë ndërtuar, nuk vijnë për shkak të decentralizimit, por, në fakt, është akoma më keq. Qeveria e ka përdorur pushtetin vendor si një instrument për t'ia futur dorën sa herë që ajo dëshironte duke bërë politikë. Ju kujtohet taksa e biznesit të vogël?!

A e keni parë në ndonjë vend që të hiqet taksa? Mund të bëjë qeveria politikë; nuk jam kundër heqjes së taksës së biznesit të vogël, por pushteti qendror mundet të bëjë kompensimin e këtyre njësive vendore me paratë që ajo ka hequr për shkak të politikës që ka bërë. Një tjetër instrument, një fakt tjetër që mund të shohim: 18 mijë të punësuar ka pasur në pushtetin vendor deri në vitin 2015, 37 mijë kemi sot. Në fakt, janë deleguar 7 kompetenca, por asnjë prej atyre nuk është funksionale. Madje, jo vetëm që nuk janë funksionale, por i kanë krijuar edhe një kosto shtesë pushtetit vendor. Nuk është e vërtetë se kjo ka ardhur për shkak të delegimit të kompetencave, por për shkak të patronazhistëve. Po shohim vetëm një instrument: ujësjellësit kishin 4 punonjës për 1 mijë lidhje, sot kanë 6 punonjës për 1 mijë lidhje. Ujësjellësit kaluan 100% për pushtetin vendor.

Pra, do të thotë se është dyfishuar numri i të punësuarve në administratë? Nëse i referohemi ujësjellësit, në 58 ujësjellës, të cilët kaluan te pushteti vendor, 56 prej tyre janë me humbje. Në fakt, vijnë me humbje, sepse vetëm në Shqipëri funksionon (nuk e di se ku është ministrja e Financave) që nuk ka korniza buxhetore. Ishim në Kroaci, një vend që, edhe pse ka 556 bashki, kishte vetëm 16 mijë të punësuar. Shqipëria me 61 bashki ka 37 mijë të punësuar. Atje nuk mund të kishe nënkryetar bashkie, nëse kishe më pak se 10 mijë banorë; atje nuk mund të kishe më shumë sesa 5 të punësuar, nëse kishe 5 mijë banorë, pra kishte kufizime. Sot ju vendosni, se thoni: “Vendos këshilli...”. Në fakt, këshilli monist vendos, i shton, i trefishon, i katërfishon për shkak të zgjedhjeve. Ju keni shpikur falimentin. A keni parë komuna dhe bashki që kanë falimentuar para vitit 2015? Sot kemi dy bashki në faliment. Sot kemi rreth njëzet bashki në prag falimenti. Ju sot po merrni shërbimin më kryesor, ujësjellës-kanalizimet, për arsye korruptive, pasi, nëse nuk do të kishit shtuar, po themi, patronazhistët, nuk do të kishim parë të thellohej situata.